



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2022:210030  
Datë: 18.09.2024  
Numri i dokumentit: 06177705

**C.nr. 2303/22.**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari Migjen Kastrati, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses, A.R nga Peja, të përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatura NIKQI&Associates, LLC, me seli në Pejë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "EUROSIG", me seli në Prishtinë, rr. "2 Korriku" nr. 4, baza juridike, zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 9,900.00 €, gjykata jashtë seancës, me datën 18.08.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. KONSTATOHET SI E TËRHEQUR** padia e datës 12.10.2022, me numër C.nr.2303/22, paditësit A.R nga Peja, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve "EUROSIG", me seli në Prishtinë, rr. "2 Korriku" nr. 4, baza juridike, zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 9,900.00 €.
- II.** Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë.
- III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi përmes të autorizuarit të tij me datën 12.10.2022 ka parashtruar padi kundër të paditurës, me bazën juridike, zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 9,900.00 euro.

Me parashtrësën e datës 07.09.2024 e autorizuar e paditëseve ka bërë tërheqjen e padisë me arsyetimin se me të paditurën ka arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, dhe përmes kësaj parashtrëse i ka propozuar gjykatës që ta lejoj tërheqjen e padisë.

Gjykata konstaton se parashtrësën për tërheqjen e padisë nga i autorizuari i paditëses, i ka dërguar të paditurës me datën 17.09.2024.

Sipas dispozitave ligjore nga neni 261 par. 1,2,3,4,5 të LPK-së, shprehimisht është përcaktuar se “pala paditëse ka të drejtë ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri të paraqet përgjigjen në padi, padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë. Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë. Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri”, u vendos si në piken **I** dhe **II** të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore - LPK-së, si në piken **III** të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet ligjore komform dispozitave ligjore nga neni 261 e lidhur me nenin 387 par.1 pika “c” dhe nenit 142.1 të LPK, duke vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2022:210030, C.nr.2303/22 i dt. 18.09.2024**

**G j y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
**Migjen Kastrati**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të dispozitës së nenit 261 par. 4 të LPK-së.